



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
GJIROKASTËR

Nr. 1489 Prot.

Gjirokastër, më 06/12/2021

Lënda: Hapet thirrja për bursat shtetërore "Stipendium Hungaricum" për shtetasit e huaj, të cilët dëshirojnë të ndjekin studimet pranë universiteteve publike të Hungarisë.

Qeveria e Hungarisë, përmes Fondacionit Publik Tempus, për vitin akademik 2022-2023, ka shpallur programin e bursave shtetërore "Stipendium Hungaricum" për shtetasit e huaj, të cilët dëshirojnë të ndjekin studimet pranë universiteteve publike të Hungarisë.

Të gjithë kandidatët duhet të aplikojnë ONLINE në faqen e Fondacionit TEMPUS apply.stipendiumhungaricum.hu deri në datën **15 janar 2022 (afati fundit)**. Përveç kësaj, kandidatët duhet të dorëzojnë detyrimisht nëpërmjet postës në adresë të Drejtorisë së Integritimit, Koordinimit, Marrëveshjeve dhe Asistencës së Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë të gjithë dokumentet e ngarkuara në sistemin online sipas kriterëve të përcaktuara nga Fondacioni Publik Tempus deri në datën **28 janar 2022 (afati i fundit)**.

Nga viti akademik 2022/2023, përveç programeve Bachelor, Master, Master një-vjeçar dhe Doktoraturë, kandidatët mund të aplikojnë edhe për kurse trajnimi të specializuara pasuniversitare të cilat ofrojnë mundësinë e përfitimit të një kualifikimi të specializuar për studentët të cilët kanë një diplomë Bachelor apo Master.

Prof. dr. Bektash Mema

REKTOR

